



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 06.02.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1194/24, për zyrtarin Arigon Sinani, anëtar i Kuvendit Komunal, Drenas/Glllogoc, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës (denoncimit) nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (*citojmë*): “[...]... njëri nga aksionaret e “NPL Stacioni i Autobusëve Drenas SH.A.” Arigon Sinani është në konflikt të hapur interesi pasi që i njëjti është akuzuar për uzurpim të pronës në po të njëjtën ndërmarrje. Kjo Ndërmarrje Publike është themeluar me iniciativën e Kuvendit Komunal të Drenasit/Glllogocit, ku si aksionar janë M.B., R. Z. dhe Arigon Sinani, ku ky i fundit (Arigon Sinani), njëkohësisht është edhe pronar me pronësi të përbashkët familjare të biznesit i cili është në lokalet e Stacionit të Autobusëve [...]”.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia ka njoftuar zyrtarin Arigon Sinani lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (*shkresa zyrtare: DPKI-1362/24*).

Më pas, me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të kësaj situatë është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin në fjalë, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast. Në takim, zyrtari ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, duke mohuar në tërësi pretendimet e raportuesit të rastit, ndërsa të njëjtat qëndrime i ka përcjellë në Agjenci edhe në formë të deklaratës, mbështetur me dokumentacion relevant.

Në deklaratën e dërguar Agjencisë (bashkë me dokumentacionin përcjellës nga zyrtari Arigon Sinani, njëherit subjekt i trajtimit për konflikt të mundshëm të interesit, theksohet se (*citojmë*):

“[...].

1. Pretendimi për konflikt interesi si përfaqësues/aksionar i Komunës së Glllogocit në Stacionin e Autobusëve - Kam marrë vendimin e Kuvendit të Komunës për të shërbyer si përfaqësues/aksionar i Stacionit të Autobusëve, një detyrë që e kam ushtruar me integritet të plotë dhe pa ndonjë përfshirje personale ose familjare që mund të krijonte konflikt interesi. Dokumenti zyrtar i emërimit tim e vërteton këtë (shih vendimin në attach Nr. 02.02049438 të dt. 27.09.2022. Kjo detyrë është e ndarë nga çdo interes personal, dhe nuk ka pasur asnjë veprim të tillë që mund të shkelë etikën profesionale.

2. Prona e [...], restoranti “Peshkopia” në stacionin e autobusëve - Lidhur me këtë pretendim, dua të theksoj se prona në fjalë është blerë në vitin 2004 shih kontratën nr:184 nga kompania “Ramiz Sadiku”, shumë kohë përpara se unë të isha i angazhuar në ndonjë pozicion publik ose vendimmarrës në Komunën e Glllogocit. Kjo pronë nuk ka asnjë lidhje me pozicionin tim si përfaqësues/aksionar i komunës së Glllogocit, prona në fjalë, është e regjistruar si pronë private e [...], S. S. dhe pjesa tjetër është pronë e stacionit të autobusëve dhe nuk ka asnjë lidhje me konflikt interesi.

3. Shfrytëzimi i terasës së restorantit - Në lidhje me pretendimin për shfrytëzimin e terasës nga restoranti “Peshkopia,” dëshiroj të njoftoj se ky biznes e ka shfrytëzuar këtë hapësirë që nga viti 2005, periudhë kur unë nuk kam pasur asnjë rol si këshilltar komunal. Kontrata për shfrytëzimin e kësaj hapësire është nënshkruar nga drejtori kompetent, pa përfshirjen time ose të asamblesë komunale. Aktualisht, kjo çështje është në proces gjyqësor dhe është nën masën e sigurimit nga gjykata, duke përjashtuar çdo mundësi për një konflikt të mundshëm interesi.

4. Vendimi në favorin e pronarit S. S. nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtjes së Ambientit nr.: [...], i dt. 23.09.2024.

Dua gjithashtu të përmend se pronari S.S., ka fituar një vendim të rëndësishëm nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtjes së Ambientit, lidhur me ankesën e pronarit ndaj pretendimeve të Komunës së Glllogocit. Ministria ka rrëzuar vendimin e Komunës dhe ky vendim është në favorin e S.S., duke konfirmuar se pretendimet e Komunës së Glllogocit me vendim Nr: [...], të dt. 29.04.2024 janë të pabazuara dhe nuk përbëjnë asnjë formë të konfliktit të interesit e as që lidhen me mua por janë në favorin e pronarit (shih vendimin nr.: [...], i dt. 23.09.2024)”.

Tutje në deklaratën e tij zyrtari Arigon Sinani thekson se:

“[...]. Lidhur me vendosjen e taksave komunale për bizneset, sqaroj se në asnjë rast nuk kam marrë pjesë në diskutime ose votime mbi këtë çështje, për arsye se një familjar imi, [...], operon një biznes në territorin e komunës sonë. Me qëllim të shmangies së çdo situatë të konfliktit të mundshëm interesi, kam qëndruar larg nga çdo vendim që mund të ndërli dhej me bizneset e familjarëve të mi.

Dua gjithashtu t'ju njoftoj se në Formularin e Deklarimit të Pasurisë, kam raportuar restorantin “Peshkopia” në Drenas si pronë të përbashkët familjare, ku është regjistruar në emër të [...] S.S., si pronar kryesor. Kjo tregon edhe më tej përpjekjet e mia për të qenë transparent në lidhje me të gjitha asetet familjare dhe për të shmangur çdo keqkuptim lidhur me situatat e mundshme të konfliktit të interesit.[...]”

Në kompletim të dokumentacionit dhe sqarimit të mëtutjeshëm të rastit në fjalë, Agjencia ka kërkuar dhe mbledhur informacion dhe dokumentacion shtesë nga institucionet relevante lidhur me rastin në trajtim.

Agjencia ka analizuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit për konflikt të mundshëm të interesit, deklaratat, sqarimet dhe dokumentacionin e dërguar nga Arigon Sinani sipas kërkesës së Agjencisë, informacionin/dokumentacionin e siguruar nga institucionet tjera relevante dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Sipas formularit të deklaramentit të pasurisë zyrtari Arigon Sinani ishte zgjedhur/emëruar anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit/Glllogocit me datë: 07.12.2017;

Me vendimin Nr. 02.02049438, të datës 27.09.2022, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit formon Komisionin Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A., Drenas/Glllogoc, ku njëri nga anëtarët nga radhët e Kuvendit të Komunës emërohet Arigon Sinani;

Ndërsa, në bazë të Kontratës mbi shitblerjen Nr. 184, të datës 25.05.2005, Kompania Aksionare Ndërtimore "Ramiz Sadiku" - Prishtinë, e përfaqësuar nga Drejtori G. S., i shet blerësit S. S., lokal in afarist Nr. 1, i cili gjendet në Objektin e 'Stacionit të Autobusëve' në Glllogoc, dhe se e njëjta është e regjistruar si pronë private e S. S.;

Agjencia ka kërkuar nga Kuvendi Komunal i Drenasit/Glllogocit informacion, *nëse dy vitet e fundit, përkatësisht nga data 01.07.2022 e në vazhdim, z. Arigon Sinani, qoftë në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës në Drenas/Glllogoc, qoftë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike Lokale 'Stacioni i Autobusëve' SH.A., në Drenas/Glllogoc, është përfshirë në ndonjë vendimmarrje eventuale lidhur me biznesin individual (Restaurant) N.T.SH. "Peshkopia", Rr. "14 Qershori", Drenas, me pronar S.S., përfshirë pjesën tjetër të marrë në shfrytëzim për nevoja të këtij biznesi (pronë publike e marrë me qira sipas kontratës), nga qiramarrësi S.S.;*

Në përgjigjen Nr.: 02-155/03-59918, të datës.: 18.12.2024, të Kuvendit Komunal të Drenasit/Glllogocit, si institucion punëdhënës i zyrtarit Arigon Sinani, thuhet se (citojmë): "[...] Duke u bazuar në të dhënat dhe njohurit që i posedon Zyra e Kuvendit të Komunës së Drenasit/Glllogocit, z. Arigon Sinani nuk ka marrë pjesë në ndonjë vendimmarrje zyrtare me të cilën janë prekur interesat e biznesit N.T.SH. 'Peshkopia' të babait të tij, z. S.S.".

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit për zyrtarin Arigon Sinani, anëtar i Kuvendit Komunal, Drenas/Glllogoc.

Kësisoj, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

si dhe me nën-paragrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës."

Ndërsa, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nocionin vendimmarrje si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të, në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin.

Në rastin konkret, është fakt se subjekti privat - restoranti "Peshkopia" në Drenas si pronë e përbashkët familjare, e regjistruar në emër të pronarit S.S. (babai i Arigon Sinanit), është person i afërm i zyrtarit Arigon Sinani, por, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara, Arigon Sinani qoftë në cilësinë e anëtarit të Kuvendit Komunal, qoftë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale 'Stacioni i Autobusëve' SH.A., në Drenas/Glllogoc, të jetë përfshirë e as ndikuar në ndonjë vendimmarrje lidhur me personin e afërt të tij, përkatësisht biznesin individual N.T.SH. "Peshkopia", në Drenas, përfshirë pjesën tjetër të marrë në shfrytëzim për nevoja të këtij biznesi (pronë publike e marrë me qira sipas kontratës), nga qiramarrësi S.S.

Prandaj, në rastet kur mungon vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes nga zyrtari (si kusht i domosdoshëm kumulativ), përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *"Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë."*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është

përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)



YLL BULESHKAJ

Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit